



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, duke bazuar në Shkresën-kërkesën për rishqyrtim të MAPL-së Nr.020-646/4 datë 07.11.2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.11.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

#### VENDIM

### PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ZK- LIPJAN

#### Neni 1

1. MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënie e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, të cilat i jepen ofertuesit:

1.1. "Kryeziu Builds" Nr.biznesit 810194647 pronare Nuriye Kryeziu B.I adresa "Mbreti Zog" nr.5 Lipjan, shfrytëzuese e pronave të paluajtshme të komunës në Zonën Kadastrale-Lipjan.

1.2. Pronat e paluajtshme të komunës të cilat jepen në shfrytëzim afatgjatë gjenden në Zonën Kadastrale në Lipjan dhe janë përshkruar sipas evidences kadastrale, si në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m <sup>2</sup>
1.	Komuna Lipjan	P-71409044-01736-1	Lipjan	1110
2.	Komuna Lipjan	P-71409044-01742-4	Lipjan	624
3.	Komuna Lipjan	P-71409044-01743-5	Lipjan	803

4.	Komuna Lipjan	P-71409044-01748-2	Lipjan	765
----	---------------	--------------------	--------	-----

1.3. Pronat komunale jepen në shfrytëzim për 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

1.4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronave të palujatshme të komunës, destinohet kryesisht për ndërtimin e objektit-ndërtesë në proporcion me koficientin e ndërtimit për sipërfaqen e pronave komunale të përshkruara si në nenin 1 pika 1.2 të këtij Vendimi, sipas projektit ideor arkitektonik "Kryeziu BUILDS".

1.5. Për të arritur interesin më të favorshëm ekonomik të Komunës së Lipjanit, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të këtyre pronave komunale, është përzgjedhur oferta me vlerë investive prej 7 mil.€ dhe me përqindjen më të lartë përfituese për Komunën prej 30% neto. Në proporcion me pronat e dhëna në shfrytëzim prej 3302 m<sup>2</sup>, Komuna përfiton rreth 4000 m<sup>2</sup> të ndërtesës, ku përfitimi i drejtpërdrejt financiar do të jetë së paku 3.5 milion €. Hapësirat e përfituara, do të shfrytëzohen ekskluzivisht për interes të përgjithshëm dhe do të kenë ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nga ushtrimi i aktiviteteve afariste, ku parashifen të punësohen dhjetëra punonjës në bizneset që do të afarojnë në rreth 1300 m<sup>2</sup> lokale afariste. Nëse e marrim parasysh ndërtesën në tërësi, atëherë përfitimet e përgjithshme financiare do të jenë disa herë më të larta se përfitimi i drejtpërdrejt për Komunën prej rreth 3.5 milion Euro.

## Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzueses të pronave të palujatshme në ZK- Lipjan.

## Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, pronat sipas nenit 1 pika 1.2 të këtij Vendimi i kthehen titullarit të pronave- Komunës.

## Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektionit, Drejtorati i Infrastrukturës dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-020/04-59398

Lipjan, më 29.11.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

